



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 14321 Prot.

Lezhë, më 30 / 07 /2021

VENDIM

Nr. 118 Datë 29 / 07 /2021

PËR

NJË NDRYSHIM NË VKB-NË NR.101, DATË 28.05.2021 “ PËR MIRATIMIN E FILLIMIT TË PROCEDURËS PËR ZGJEDHJEN E KRYESISË SË FSHATIT TRESH, NJËSIA ADMINISTRATIVE ZEJMEN, BASHKIA LEZHË, PËR SHKAK TË NDARJES NGA JETA TË ANËTARIT TË ZGJEDHUR TË LAGJES MANATI (FILDANE)”

Mbështetur ne Ligjin 139/2015, datë 17.12.2015, "Për Vetëqeverisjen Vendore", neni 8 pika 2, neni 9 pika 1.1, gërmat b dhe d, neni 53, neni 54 gërma a) dhe në Rregulloren e Këshillit të Bashkisë Lezhë e miratuar me Vendimin Nr. 54, datë 28.04.2020 të Këshillit Bashkiak, e konfirmuar me Nr. 358/1 Prot., datë 15.05.2020 nga Prefekti i Qarkut Lezhë, Këshilli i Bashkisë Lezhë, pas diskutimeve;

VENDOSI:

1. Pika 1 e VKB-së nr.101, datë 28.05.2021 ndryshohet si më poshtë vijon:
“Miratimin e fillimit të procedurave për zgjedhjen e anëtarësisë së kryesisë së fshatit Treshë, Njësia Administrative Zejmen, Bashkia Lezhëm në lagjen Manati (Fildane), për shkak të ndarjes nga jeta të anëtarit të zgjedhur të kësaj lagjeje, brenda datës 30.09.2021”
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Këshilli i Bashkisë Lezhë.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar.

SEKRETARI

FLORIDA ÇUNAJ

KRYETARI

ERNEST RAKAJ

